

# “AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE”

## KRIJIMI, FUNKSIONI DHE SFIDAT



*Tiranë  
dhjetor 2020*

Kliti STARJA  
Drejtore i pergj. AKP  
Bilena HYSENI  
Pergj. e Sektorit të Informacionit  
dhe Kërkimit Shkencor

# ZH V I L L I M E T N Ë S E K T O R I N E P Y J E V E

31 Dhjetor 2018, KM  
miratoi Dokumentin e  
Politikave për Pyjet  
(2019-2030)

Politikat për  
Pyjet

4 shkurt 2016, ligji “Për  
shpalljen e  
Moratoriumit për pyjet”

Ngritja  
e AKP

VKM Nr. 570, datë 17.7.2019  
“Për krijimin, organizimin dhe  
funksionimin e Agjencisë Kombëtare të  
Pyjeve”

Urdhri Nr. 24, datë 03.02.2020  
“Për miratimin e strukturës dhe  
organigramës të Agjencisë  
Kombëtare të Pyjeve”

Urdhri i KM


Ligji

LIGJ  
Nr. 57/2020  
“Për Pyjet” dt.30/04/2020

**Agjencia Kombëtare e Pyjeve**, ka si mision: *“Mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare”*.

AKP - funksionet drejtuese në sektorin e pyjeve. Ka rolin e një autoriteti që garanton performancën dhe efikasitetin e sektorit, siguron standarde dhe metodologji për aktivitetet dhe operacionet e sektorit, angazhon palët e interesuara dhe forcon koordinimin/bashkëpunimin midis tyre. Krijon një sistem të përshtatshëm për mbledhjen e informacionit dhe transferimin e njohurive.

# MISIONI DHE QËLLIMI



- **AKP është një institucion publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për pyjet (aktualisht MTM);**
- **Përgjegjëse për garantimin e performancës dhe standardeve në lidhje me fondin pyjor kombëtar;**
- **Ka statusin e personit juridik shtetëror, që financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burimet e veta;**

# IKPK 2018-2020

## SIPËRFAQJA PYJORE

- 1.2 milion ha, 36% të sipërfaqes së vendit;
- ku 97% janë pyje publikë dhe 3% private;
- Mesatarja: 0.42 ha/banor;

## TIPOLOGJIA E FONDIT PYJOR

- 36% trungishte, 46% cungishte dhe 36% shkurre;
- 11 % pyje halore, 79 % fletorë, dhe 10 % të përzier

## SHTRIRJA E FONDIT PYJOR

- 41% në Rajonin Verior,
- 17% në Rajonin Qendror,
- 30% në Rajonin Jug-Lindor,
- 12% në Rajonin Jug-Perëndimor.

1

## VOLUMI I LËNDËS DRUSORE

- 55 milion m<sup>3</sup>, me një rënie prej 20 milion m<sup>3</sup> nga viti 2005.
- **“vend i pasur me pyje të varfër”.**

2

3

## MOSHA E PYJEVE

- 35% trungishte me moshë mbi 80 vjet,
- 6% cungishte me moshë mbi 40 vjet,
- 30% shkurre me moshë mbi 20 vjet.
- **“Pyje të rinj”**

4

5

## KATEGORIZIMI I PYJEVE SIPAS FUNKSIONIT

- 67 % prodhues;
- 11 % mbrojtës;
- 23 % biodiversitet.

6

# PYJET SI BIOMASE

## PYJET MBROJTES PER TOKEN UJIN AJRIN

Perdorimi kryesor drute e zjarrit: Studim I BB 2018


- 2,27 milion m<sup>3</sup> RWE në vitin 2016
- 2,17 milion m<sup>3</sup> RWE nga familjet
- 100.295 m<sup>3</sup> RWE nga përdoruesit e mëdhenj
- 96%) janë konsumuar nga familjet.
- për ngrohje (31%),
- e ndjekur nga gatimi (49%)
- dhe ngrohjen e ujit (20%).

# AKTE TE TJERA LIGJORE QE NDIKOJNE MBI VEPRIMTARINE E AGJENCISE (2)

## AKTE TË TJERA

1. **Ligji nr. 139/2015**, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
2. **Ligji nr. 81/2017**, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”
3. **Ligji nr.10 431**, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
4. **Ligji nr. 5/2016, datë 04.02.2016** “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”,
5. **VKM nr. 102, datë 4.2.2015** “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”
6. **VKM nr. 438, datë 8.6.2016** “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”;
7. **VKM nr. 433, datë 8.6.2016** “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”;
8. **VKM nr. 568, datë 17.7.2019** “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”
9. **VKM nr.746, datë 23.6.2009** “Për përcaktimin e tarifave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve, që përdoren për ndërtimin e veprave industriale”;
10. **VKM nr.1353, datë 10.10.2008** “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”,
11. **Udhëzim nr.4, datë 12.9.2008** “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor”;
12. **Udhëzim nr. 2, datë 3.3.2017** “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”;
13. **Udhëzim nr. 1, datë 9.6.2016** “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, etj.

# PROFILI I AKP




- AKP është një institucion publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për pyjet (aktualisht MTM);
- Përgjegjëse për garantimin e performancës dhe standardeve në lidhje me fondin pyjor kombëtar;
- Ka statusin e personit juridik shtetëror, që financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burimet e veta;
- Është institucion i organizuar në **nivel qendror dhe në nivel rajonal** nëpërmjet ARP-ve. Ka në varësi të saj 4 ARP, sipas VKM nr. 570, datë 17.7.2019, “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”;
- Ka varësi funksionale, komunikon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me drejtoritë dhe sektorët përkatës të Aparatit të Ministrisë.

# Ndërveprimi Institucional

- **Bashkitë:** kryejnë *funksione manaxheriale & operacionale*.

Sipas ligjit:

- atribuete *menaxhuese, kontrolli / inspektimi, teknike dhe këshillimi*, për fondin kombëtar pyjor në pronësi;



## Ministria që mbulon pyjet (Aktualisht MTM):

Përgjegjëse për udhëheqjen/administrimin e sektorit të pyjeve. Funkzioni drejtues përfshin tre funksione themelore që janë *politikëbërja, funksionet rregullatore, financimi dhe zhvillimi i sektorit*.

**AKP - funksionet drejtuese** në sektorin e pyjeve. Ka rolin e një *autoriteti* që garanton performancën dhe efikasitetin e sektorit, siguron standarde dhe metodologji për aktivitetet dhe operacionet e sektorit, angazhon palët e interesuara dhe forcon koordinimin/bashkëpunimin midis tyre. Krijon një sistem të përshtatshëm për mbledhjen e informacionit dhe transferimin e njohurive.

## Agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura:

Kryen *funksione manaxheriale* (planifikimin, ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve dhe shërbimeve pyjore) *dhe operative* për atë pjesë të fondit pyjor që përfshihet në zonat e mbrojtura.

# FUNKSIONET E AKP

## Ligji 57/2020 “Për pyjet”

- Sigurimin e **performancës në sektorin e pyjeve**, vlerësimin e gjendjes së pyjeve dhe impaktit të sektorit;
- **Mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm** të burimeve pyjore;
- Propozimin tek ministri për vendosjen e **normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave** më të mira të unifikuara në fushën e pyjeve;
- Zbatimin e sistemeve të **certifikimit të pyjeve** të pranuar në nivel ndërkombëtar;
- **Garantimin e koordinimit, të bashkëveprimit dhe të angazhimit të strukturave përgjegjëse** për pyjet, në nivel qendror dhe vendor, si dhe të aktorëve të tjerë (OJF, biznese, komunitete etj.);
- Ngritjen dhe funksionimin e **sistemit të integruar të informacionit mbi pyjet** në nivel kombëtar, si dhe harmonizimin e kërkimit shkencor në fushën e pyjeve;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të **kërkesave ligjore dhe të dokumenteve planifikues në pyje**, si dhe këshillimin e ndërgjegjësimit e aktorëve në lidhje me detyrimet mbi pyjet;
- Garantimin e **funksionalitetit të sistemit të kontrollit dhe të inspektimit** të veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar, duke ndërhyrë sipas përcaktimeve në këtë ligj.
- Ngre dhe mirëmban **Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor**;
- Harton metodologjinë për **inventarizimin e pyjeve**, organizimin dhe drejtimin e punës në nivel kombëtar ;
- Organizon Rrjetin e Përhershëm të **Monitorimit të Fondit Pyjor Kombëtar**;
- **Përpunon dhe nxjerr rezultatet e monitorimit**, si dhe harton dhe publikon raportin vjetor për gjendjen e fondit pyjor si pjesë të raportit për gjendjen e mjedisit;
- Monitoron në mënyrë të vazhdueshme **zbatimin e dokumenteve planifikuese** dhe raporton para ministrit;
- Ministria, bashkitë dhe agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet planifikojnë çdo vit **fondet e nevojshme për fondin pyjor publik**;

VKM-në nr.570, datë 17.07.2019

Përgjegjësitë funksionale të AKP-së janë kategorizuar në 5 grupe kryesore:

- sigurimin e performancës në sektorin e pyjeve;
- vlerësimin e gjendjes së pyjeve;
- organizimin e punës për inventarizimin dhe kërkimin në fushën e pyjeve;
- organizimin e punës dhe hartimin e dokumenteve për menaxhimin e pyjeve;
- organizimin e punës për monitorimin dhe kontrollin e pyjeve.

# SFIDAT PËR TË ARDHMEN

## Qartësimi i rolit dhe përgjegjësi të AKP përkundrejt strukturave:

1

Roli i AKP për mbështetjen e **Ministrisë** në **hartimin e politikave strategjive** përmes vënies në dispozicion të informacionit mbi pyjet, përpunimit dhe strukturimit të tij, si dhe ofrimit të ekspertizës së nevojshme për aspekte të karakterit teknik;

2

Roli i AKP në mbështetjen e **Ministrisë në hartimin e akteve rregullatore nënligjore** kryesisht të urdhrave dhe udhëzimeve të miratuara nga Ministri;

3

Përgjegjësi të AKP mbi **RKFP dhe sistemin e informacionit ALFIS**;

4

Percaktimi i mekanizmave të bashkëpunimit brenda agjencisë duke përcaktuar qartë rolin e agjencisë qendrore dhe agjencive rajonale (në momentin e krijimit të tyre) përsa i përket procesit të inventarizimit dhe duke saktësuar peshën e agjencive;

# PROPOZIME NË RISHIKIMIN E FUNKSIONEVE TË AKP

5

Përgjegjësia e AKP për organizimin e **Rrjetit të Përhershëm të Monitorimit të Fondit** Pyjor Kombëtar dhe hartimin e **programit të monitorimit**;

6

Parashikimi të një **strukture të specializuar tekniko-shkencore** për analizimin/shqyrtimin e dokumenteve me **karakter teknik** të tillë si udhëzues, manuale, standard që lidhen me veprimtarinë në pyje;

7

Roli AKP në lidhje me **certifikimin e punimeve të terrenit, certifikimin e rezultateve si dhe miratimi** apo pranimi i këtyre punimeve;

8

Sqarimi/detajimi i rasteve dhe procesit/procedurës për rastet kur AKP ndërhyr duke ushtruar **kompetencat e NjVV-ve në lidhje me inspektim-kontrollin**.

# HAPAT NË VAZHDIM

1

## NDRYSHIMET/AMENDIMET LIGJORE

- Draftimi & miratimi i akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” – për ndjekje nga MTM & mbështetje nga AKP
- Amendimi i VKM nr. 570, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë kombëtare të pyjeve”, të ndryshuar;
- Amendimi i Urdhërit nr.24, datë 3.2.2020, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” - sipas propozimeve për rishikimin e strukturës ekzistuese;
- Miratimi i Urdhërit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit “Për shtrirjen territoriale dhe përcaktimin e qarqeve ku do të ngrihen 4 Agjencitë Rajonale të Pyjeve”

2

## AGJENCI FUNKSIONALE

- *Hartimi dhe miratimi i manualit të procedurave të AKP (know - how) – janë zbërthim i politikave dhe rregullojnë aktivitetin e agjencisë, tregojnë linjën e kryerjes së proceseve të punës, përgjegjësitë dhe afatet kohore.*
- *Hartimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës për të gjithë pozicionet e punës - do të garantojnë zbërthimin e përgjegjësive deri në nivel pozicioni pune duke dhënë një pasqyrë më të detajuar lidhur me misionin, qëllimin, objektivat, detyrat, përgjegjësitë dhe kriteret e çdo pozicioni.*



**FALEMINDERIT!**

